



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2020:018757

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05759892

CN. nr. 4/2020

Gjykata Themelore Gjilan - Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, përmes gjyqtares Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike jo kontestimore të propozuesit S. St. nga, të cilin sipas autorizimit të dhënë nga ZNJF në e përfaqëson Valastimir Petroviq, avokat nga Gjilani, e paraqitur kundërpropozuesit DP “Magnohrom”, në Kamenicë, tani nën autoritetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më seli në Prishtinë, për nxjerrjen e aktvendimit për zëvendësimin e kontratës për blerjen e banesës, jashtë seancës gjyqësore, më datë 30.05.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

I. Hedhet poshtë propozimi me numër CN.nr.4/2020, i datës 21.01.2020, i propozuesit S. S. nga, i paraqitur kundër propozuesit DP “Magnohrom”, në Kamenicë, tani nën autoritetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më seli në Prishtinë, për nxjerrjen e aktvendimit për zëvendësimin e kontratës për blerjen e banesës, si të pas afatshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës jo kontestimore.

A r s y e t i m i

Propozuesi S.S. nga përmes të autorizuarit të tij, me datë 21.01.2020, në këtë gjykatë, ka paraqitur propozim për marrjen e aktvendimit I cili e zëvendëson kontratën mbi blerjen e banesës, ndaj kundër propozuesit DP “Magnohrom”, në Kamenicë, tani nën autoritetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprak të propozimit, ka vlerësuar se kërkesa e propozuesit është paraqitur pas kalimit të afatit 3 vjeçar, komfor nenit 7 parag.4, të Ligjit Nr.04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore, si dhe nenit 1 të Ligjit Nr.04/L-247 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore, po ashtu mos shfrytëzimit edhe të afatit shtesë prej 24 muajve, kjo në bazë të nenin 2 të Ligjit Nr.04/L-011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për Shitjen e

Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-247, i dt.22 mars 2022.

Ne rastin konkret, propozuesi kërkesën për zëvendësimin e kontratës mbi blerjen e banesës e ka paraqitur me dt.21.01.2020, ndërsa Ligjit Nr.04/L-061, ka hyrë në fuqi me dt.12 janar 2012, çka ne rastin konkret propozuesi këtë të drejtë ka mundur ta shfrytëzoj deri ne vitin 2014, mirëpo me Ligjit Nr.04/L-247, afati prej dy (2) vjetësh është zëvendësuar me afatin tri (3) vjetësh nga hyrja në fuqi e ligjit bazik, pra deri ne vitin 2015, për paraqitjen e kërkesës, po ashtu palëve iu është dhënë mundësia edhe me Ligjit Nr.04/L-011, sipas nenit 2 që “*Ministri me vendim mund ta vazhdojë afatin e përcaktuar në paragrafin 3, të këtij neni për dy (2) herë radhazi dhe afatet e vazhduara nuk mund ta tejkalojnë dymbëdhjetë (12) muaj secili*”, çka propozuesi nuk e ka argumentuar me asnjë provë në shkresat e lëndës se i njëjti ta ketë shfrytëzuar këtë të drejtë, prandaj e drejta e propozuesit për realizimin e të drejtave përmes rrugëve gjyqësore është e pas afatshme, meqë është paraqitur pas vitit 2019, kur edhe ka qenë afati i fundit për paraqitjen e kërkesave sipas legjislacionit në fuqi, respektivisht propozuesi kërkesën në gjykatë e ka paraqitur një vit më vonë, pra me dt.21.01.2020.

Ndërsa sa i përketë shpenzimeve të procedurës jo kontestimore, vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta konform nenit 452 të LPK-së, ngase në këtë çështje juridike jo kontestimore nuk janë shkaktuar shpenzime.

Nga të cekurat më lartë, gjykata, duke u bazuar në nenin 391 pika f) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHME - DIVIZIONI CIVIL
2020:018757, 30.05.2024**

Gjyqtarja,

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë.